

# EUREM Shqipëri

Trajnimi Menaxher European i Energjisë



Përgatitur nga:  
Austrian Institute of Excellence  
[www.aie.al](http://www.aie.al)

# Historia e EUREM

Në 1999 Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Nuremberg (NCCI) i dha jetë iniciativës EUREM dhe zhvilloi trajnimet e para praktike „Menaxher Energjie (NCCI)“ në Gjermani.


EUREM në vijim u zhvillua në 2003 - 2005 në kuadër të një projekti evropian nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Nuremberg (NCCI) në rolin e koordinatorit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Gjermano-Portugeze në Lisbonë (DUAL), Instituti i Energjisë në Londër dhe Dhoma Ekonomike Austriake (WKÖ) në Vjenë.

## Hyrje

EUREM është një program trajnimi ambicioz i standardizuar dhe një rrjet i suksesshëm për Menaxherët Evropian të Energjisë, i cili tashmë është i pranishëm në 27 vende në të gjithë botën. Deri më tani, më shumë se 5,000 Menaxherë të Energjisë garantojnë efikasitetin e energjisë në kompanitë e tyre.

EUREM vjen në Shqipëri i mundësuar nga Austrian Institute of Excellence, pas organizimit dhe zbatimit të grupit pilot financuar nga Bashkimi Evropian, EUREMnext.

Trajnimi do të vazhdojë të organizohet në Shqipëri nga Austrian Institute of Excellence si partneri zyrtar i licensuar i EUREM në Shqipëri.



# Përse na duhet EUREM?

Trajnimet e para u zhvilluan në vitin 2004 në Gjermani, Austri, Britani e Madhe e Portugalit dhe në 2008 në Republikën Çeke, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Itali, Poloni, Slloveni dhe Spanjë. Dhjetë nga këto trembëdhjetë vende ofruese të EUREM u bashkuan për të formuar Konsortiumin EUREM me synim të ofrojnë rregullisht trajnimin dhe njëkohësisht të përhapin markën EUREM në të gjithë botën, edhe mbas përfundimit të projekteve fillestare të cilat u financuan nga BE.

Më shumë se 500 Menaxherë Energjie janë aktualisht të regjistruar në këtë kurs, çka bën që kufiri i 5,000 Menaxherëve European të Energjisë të kalohet shumë shpejt. Marka EUREM ka për qëllim të shtrihet akoma më të gjërë për t'iu dhënë mundësinë më shumë personave të bëhen ekspertë të kualifikuar/ akredituar, ose për t'iu dhënë atyre mundësinë të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë që tashmë i kanë.

Qëllimi i trajnimit dhe i ISA-ve (aktivitetet mbështetëse për zbatimin) është rritja e cilësisë së rezultateve të auditimit të energjisë, probabilitetin e zbatimit të rekomandimeve dhe së fundmi efikasitetin energjistik dhe konkurrueshmërinë e kompanive të trajnuesve ose (në rastin e konsulentëve/ auditorëve të jashtëm) klientëve të tyre.



## Qëllimet dhe arritjet EUREM

- Lehtësimi i ekonomisë
- Sigurimi i energjisë
- Mbrojtja e mjedisit

# Objektivi dhe impakti EUREM

Objektivi kryesor strategjik i EUREM është të kontribuojë si në mbrojtjen e mjedisit ashtu edhe në konkurrueshmërinë e bizneseve duke rritur cilësinë e auditimeve energjitike e si pasojë dhe rritjen e masave për eficiency e energjisë.

Ekzistenca dhe rritja e pranisë dhe gatishmërisë së ekspertëve të kualifikuar dhe akredituar në këtë fushë na siguron një pamje të gjerë e të detajuar si nga ana teknike/ inxhinierike sikundër nga aspektet ekonomike/ financiare.

Sipas statistikave Menaxherët e Energjisë në mbarë botën punojnë për projekte me një potencial mesatar kursimi prej rreth 600 - 750 MWh/a energji përfundimtare secili. Këto projekte zbatohen në masë rreth 75% (në disa vende edhe 90%) plotësisht ose pjesërisht.

Këta ekspertë të trajnuar japin një kontribut në rritjen e efikasitetit të energjisë në kompaninë që i punëson (direkt ose si konsulent), duke arritur kështu objektivat e eficiency së energjisë dhe angazhimet për reduktimin e efektit serrë në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe evropian. Në të njëjtën kohë, ato kontribuojnë në ruajtjen e konkurrencës së bizneseve evropiane.

## EUREM e arrin këtë gjë nëpërmjet:

- Rritjes së kapaciteteve dhe aftësive
- Përgatitjen e terrenit për investime
- Përdorimin e politikave
- Kursimin e energjisë
- Nxitjen & prodhimin e energjisë së rinovueshme



# Kohëzgjatja, kostot & organizimi i trajnimit

Trajnimi EUREM është parashikuar të nisë në Tetor 2019 dhe do të mbahet çdo dy fundjava, të Premteve pasdite (16:00 - 20:00) dhe të Shtunave (09:00 - 16:00 max).

Tarifa e trajnimit është 120,000.- Lek pa TVSH.

Mësimi do të kryhet në shqip në ambjentet e Austrian Institute of Excellence, Tiranë.

Gjatë secilës orë mësimore pjesëmarrësit do të marrin materialet e përbëra nga prezantime, pjesë teorike, shembuj praktik në formë elektronike.

Për të mbyllur me sukses trajnimin dhe çertifikuar si Menaxher European i Energjisë është e nevojshme prania në të paktën 80% të orëve mësimore ballë për ballë si edhe kalimi në test dhe prezantimin e konceptit në më shumë se 50% të pikëve totale.

*Kurrikula prej 19 modulesh do të zhvillohet gjatë harkut kohor Tetor 2019 - Qershor 2020, në përfundim të së cilës do të kryhet testi përfundimtar dhe prezantimi i Konceptit energjitik.*

*Target grup kryesor janë inxhinierë elektrikë, mekanikë, ndërtimi, procesesh, specialistë mirëmbajtjeje godinash, stacionesh apo shërbimesh, etj.*

- Testi me shkrim zgjat 120 minuta dhe përmban në total 50 pikë. Për t'a kaluar me sukses praktikanti duhet të rezultojë kalues me të paktën 26 pikë të mbledhura.
- Koncepti energjitik (i përgatitur shqip dhe anglisht, jo më shumë se 20 faqe) si detyrë praktike përmban në total 50 pikë, nga të cilat praktikanti për të rezultuar kalues duhet të mbledhë të paktën 26 pikë. Nga 50 pikët e konceptit energjitik 35 pikë i përkasin përgatitjes dhe 15 pikë prezantimit të tij (jo më shumë se 10 minuta) para Komisionit vlerësues.
- Përgjatë kohës së zhvillimit dhe përpunimit të konceptit praktikanti do të ketë mbështetjen dhe do të mbikëqyret nga një prej trajnerëve EUREM.

# Modulet

- Bazat shkencore
- Teknologjitë e matjeve dhe kontrollit
- Ligjet dhe tregtimi i energjisë
- Efiçenca e energjisë
- Menaxhim Projekti
- Sistemet e menaxhimit të energjisë
- Fotovoltaiket
- Ndërtesat
- Biomasa, Biogazi dhe energjia gjeotermike
- Ajri i kompresuar;
- Ajri i kondicionuar
- Energjia termike diellore
- Motorrët elektrik
- Teknologjia e informacionit “e gjelbër”
- Ndriçimi
- Proceset e ngrohjes
- Teknologjitë e nxehjes
- Bashkëprodhimi/ Kogjenerimi
- Teknologjitë e ftohjes



Aktiviteti	Kohëzgjatja e parashikuar
Faza 1 – Trajnimi në klasë dhe mësimi autodidakt në rrjet	Tetor '19 – Qershor '20
Faza 2 – Përgatitja për zhvillimin dhe prezantimi para komisionit i Konceptit Energjistik	Maj '20 – Qershor '20
Faza 3 – Përgatitja dhe zhvillimi i testit me shkrim	Qershor '20 – Korrik '20
	<b>Tetor '20 – Certifikimi EUREM</b>

# Kush mund të marrë pjesë dhe specializohet Menaxher European i Energjisë

Përveç përgatitjes akademike të preferuar në degë teknike/inxhinierike, për një përjasje më të mirë preferohet që pjesëmarrësit të kenë një eksperiencë prej të paktën 3 (tre) vite punë në profesion.

“

*Për të qenë të suksesshëm, më së pari ne duhet të identifikojmë dhe dimë cilat janë problemet aktuale si dhe cilat janë programet bashkëkohore të cilat i japin zgjidhje këtyre problemeve.*

”

# Faza e zbatimit të njohurive të marra

Menaxherët tanë të Energjisë janë „ushtria“ e efikasitetit energjitik. Ata nuk e ngarkojnë ekonominë, përkundrazi e lehtësojnë atë. Ata nuk krijojnë kosto por gjejnë zgjidhje të cilat i rifitojnë ato brenda një kohe të shkurtër, duke ndihmuar kështu në zvogëlimin e kostove dhe rritjen e konkurrueshmërisë së kompanive përkatëse, ndërkohë që kontribuojnë ndjeshëm në mbrojtjen globale të klimës.

Parimi ynë është i qartë: Proud to save (Krenarë që kursejmë)

Ne jemi krenarë për Menaxherët tanë të Energjisë, për fuqinë e tyre krijuese dhe rezultatet që ata janë të aftë të paraqesin.

